

020 NUMRI I BIBLIOGRAFISË KOMBËTARE

Kjo fushë përmban numrin, të cilin institucioni kombëtar bibliografik i ndanë njësisë bibliografike në bibliografinë kombëtare, dhe kodin për shtetin e këtij institucioni.

Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
020	Numri i bibliografisë kombëtare	r
a	<i>Kodi i shtetit</i>	nr
b	<i>Numri</i>	nr
z	<i>Numri i gabuar</i>	r

Treguesit

Vlerat e treguesve nuk janë të përcaktuara.

PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

020a Kodi i shtetit

Shteti i bibliografisë kombëtare.

020b Numri

Numri, të cilin e ndanë institucioni kombëtar bibliografik.

020z Numri i gabuar

Numri, i cili i është ndarë gabim njësisë bibliografike (shih shembullin 2).

SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Numri i bibliografisë kombëtare shënohet në nënfushën b në të njëjtën formë siç e ka ndarë institucioni bibliografik, duke përfshirë hapësirat, vizat dhe shenjat e tjera të pikësimit. Kodi i shtetit vendoset në nënfushën a sipas standardit ISO 3166

Numrin e gabuar mund ta shënoni në nënfushën z. Kur dihet vetëm numri i gabuar, plotësohet vetëm nënfusha a dhe z.

Në sistemin COBISS.SI fushën e plotëson vetëm Biblioteka Kombëtare dhe Universitare. Në nënfushën a përdoret kodi "SI" – *Slovenia*, ndërsa në nënfushën b kodet nga lista lokale e kodeve e Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare.

SHEMBUJ

1.

020	uu	aAU b67-6 (<i>Numër i bibliografisë kombëtare australiane.</i>)
-----	----	---

2.

020	uu	aCA bCM73-6722XF
020	uu	aCA zCM78-6722XF (<i>Numri i saktë dhe i gabuar i bibliografisë kanadeze.</i>)

3.

020	uu	aDD b83,A16,0553
020	uu	aDD b82,N46,0092 (<i>Regjistrimi për njësinë në "Deutsche Bibliographie" përmban fushën e përsëritshme 020, sepse njësia është shfaqur dy here në bibliografi; version i parë i regjistrimit ka qenë regjistrimi CIP. Megjithëse regjistrimi që përmban fushat e përsëritshme është thjesht një përmirësim i regjistrimit CIP, ai përmban edhe numrin e mëparshëm, sepse në këtë institucion katalogojnë në këtë mënyrë.</i>)

4.

020	uu	aGB bB81-15605 (<i>Numër nga "British National Bibliography".</i>)
-----	----	--

5. *

020	uu	aSI bM1998K1 (<i>Numër nga bibliografia sllovene e librave.</i>)
-----	----	--